



Në bazë të nenit 103 të Ligjit për arsim të lartë të RMV-së, Statutit të Universitetit të Tetovës, Vendimit nga mbledhja e Këshillit të Rektoratit të datës 20.03.2019 me nr. 02-1069/1, Rregullores për kushtet, kriteret dhe rregullat për regjistrimin e studentëve në studimet e ciklit të dytë në Universitetin e Tetovës, si dhe në bazë të Vendimit të Qeverisë së RMV-së me numër 45-4839/1 të datës 04.07.2019 (Gazeta Zyrtare e RMV-së 139/19), Universiteti i Tetovës shpall:

KONKURS

për regjistrimin e studentëve në ciklin e dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës, në vitin akademik 2019/20

- I. **Numri i studentëve:** Universiteti i Tetovës në studimet e ciklit të dytë, në vitin akademik 2019/20, do ta regjistrojë numrin e studentëve si në vijim:

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE - NATYRORE	ECTS**	Thirrja shkencore	Euro/Sem estër	Numri i studentëve
Matematikë	60	Magjistër i shkencave matematikore	750	60
Gjeografi	60	Magjistër i shkencave të gjeografisë	750	15
Informatikë	60	Magjistër i informatikës	750	40
Informatikë	120	Magjistër i informatikës	500	
Informatikë (program studimor në gjuhën angleze)	60	Magjistër i informatikës	750	
E-Teknologji bashkëkohore	60	Magjistër i informatikës-E-Teknologji bashkëkohore	750	40
Sistemet për bazat e të dhënave	60	Magjistër i informatikës - Sistemet për bazat e të dhënave	750	
Biologji*	60	Magjistër i biologjisë	750	36
Botanikë		<i>moduli</i>		
Zoologji		<i>moduli</i>		
Biokimi		<i>moduli</i>		
Kimi	60	Magjistër i kimisë	750	84
Ekologji	60	Magjistër i ekologjisë	750	
Fizikë			750	40
Biofizikë	60	Magjistër i shkencave të fizikës, moduli: Biofizikë		
Fizika e materialeve	60	Magjistër i shkencave të fizikës, moduli: Fizikë e materialeve		
Fizikë e përgjithshme	60	Magjistër i fizikës, Fizikë e përgjithshme		
Fizika teorike	60	Magjistër i fizikës, Fizikë teorike		
Fizika e materialeve (program studimor në gjuhën angleze)	60	Magjistër i shkencave të fizikës, moduli Fizikë e materialeve	750	15
FAKULTETI PEDAGOGJIK	ECTS	Thirrja shkencore	Euro Semestër	
Pedagogji				60
Pedagogji - inovacione didaktike	60	Magjistër i pedagogjisë - inovacione didaktike	750	
Pedagogji - arsimim elementar	60	Magjistër i pedagogjisë - arsimim elementar	750	



Pedagogji - menaxhimi në arsim	60	Magjistër i pedagogjisë - menaxhimi në arsim	750	
FAKULTETI FILOZOFIK		ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	
Filozofi				10
Filozofi bashkëkohore	60	Magjistër i shkencave filozofike në fushën e filozofisë bashkëkohore	750	
Sociologji			750	40
Shoqëria dhe problemet globale	60	Magjistër i shkencave sociologjike, drejtimi: shoqëria dhe problemet globale		
Studime kulturologjike	60	Magjistër i shkencave sociologjike, drejtimi: studimet kulturologjike		
Histori			750	10
Historia e mesjetës	60	Magjistër i shkencave të historisë - historia e mesjetës		
Historia e kohës së re	60	Magjistër i shkencave të historisë - historia e kohës së re		
Historia bashkëkohore	60	Magjistër i shkencave të historisë - historia bashkëkohore		
Psikologji				40
Psikologji pedagogjike	60	Magjistër i psikologjisë - psikologji pedagogjike	750	
Psikologji klinike	60	Magjistër i psikologjisë - psikologji klinike	750	
Psikologji organizative	60	Magjistër i psikologjisë - psikologji organizative	750	
Filologji orientale				30
Gjuhë dhe letërsi turke	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsisë turke	750	
Gjuhë dhe letërsi arabe	60	Magjistër i gjuhës dhe letërsisë arabe	750	
FAKULTETI FILOLOGJIK		ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	
Gjuhë dhe letërsi shqipe			750	30
Gjuhë shqipe	60	Magjistër i gjuhës shqipe		
Letërsi shqipe	60	Magjistër i letërsisë shqipe		
Gjuhë maqedone			750	25
Gjuhë maqedone	60	Magjistër i gjuhës maqedone		
Letërsi maqedone	60	Magjistër i letërsisë maqedone		
Gjuhë dhe letërsi angleze			750	40
Gjuhë angleze	60	Magjistër i gjuhës angleze		
Letërsi angleze	60	Magjistër i letërsisë angleze		
Metodologjia e mësimdhënies së gjuhës angleze	60	Magjistër i metodologjisë së mësimdhënies së gjuhës angleze		
Gjuhë dhe letërsi gjermane			750	15
Gjuhë gjermane	60	Magjistër i gjuhës gjermane		
Gjuhë dhe letërsi frënge			750	10



Gjuhë frënge	60	Magjistër i gjuhës frënge		
Letërsi frënge	60	Magjistër i letërsisë frënge		
FAKULTETI I ARTEVE	ECTS Thirrja shkencore		Euro Semestër	
Art figurativ				40
Skulpturë	60	Magjistër i artit figurativ në skulpturë		
Grafikë	60	Magjistër i artit figurativ në grafikë		
Dizajn grafik	60	Magjistër i artit figurativ në dizajn grafik		
Pikturë	60	Magjistër i artit figurativ në pikturë		
FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE	ECTS Thirrja shkencore		Euro Semestër	
Kulturë Fizike				45
Menaxhment sportiv dhe rekreacion	60	Magjistër i menaxhmentit sportiv dhe rekreacionit		
Edukim fizik	60	Magjistër i edukimit fizik		
Shkenca sportive	60	Magjistër i shkencave sportive		
FAKULTETI JURIDIK	ECTS Thirrja shkencore		Euro Semestër	
Studimet e drejtësisë			500	120
E drejta civile	120	Magjistër i së drejtës, drejtimi: e drejta civile	500	
E drejta penale	120	Magjistër i së drejtës, drejtimi penal	500	
E drejta administrative-kushtetuese	120	Magjistër i së drejtës, drejtimi: e drejta administrative-kushtetuese	500	
E drejta dhe marrëdhënie ndërkombëtare	120	Magjistër i së drejtës, drejtimi: e drejta ndërkombëtare dhe marrëdhënie ndërkombëtare	500	
Gazetari dhe medime	60	Magjistër në gazetari dhe medime	750	15
Gazetari dhe medime	120	Magjistër në gazetari dhe medime	500	15
Studime politike - Marrëdhënie ndërkombëtare dhe studimet evropiane	60	Magjistër i studimeve politike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve evropiane	750	20
Marrëdhënie ndërkombëtare dhe studimet evropiane (program studimor në gjuhën angleze)	60	Magjistër i studimeve politike në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe studimeve evropiane	750	10
FAKULTETI EKONOMIK	ECTS Thirrja shkencore		Euro Semestër	
Menaxhimi i resurseve njerëzore	60	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e menaxhimit me burime njerëzore	750	
Menaxhment	60	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e menaxhmentit	750	120
Marketing	60	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e marketingut	750	



Marketing-menaxhment	120	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e marketing-menaxhmentit	500
Turizëm	60	Magjistër i menaxhimit të turizmit dhe hotelerisë	750
Kontabilitet dhe revizion	60	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e kontabilitet dhe revizion	750
Financa, banka dhe sigurime	60	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e financave, bankave dhe sigurimeve	750
Financa dhe kontabilitet	120	Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e financave dhe kontabilitetit	500

ADMINISTRIM BIZNESI

Program studimor për marrjen e diplomës së përbashkët në ciklin e dytë të studimeve universitare me Northern Illinois University (program studimor në gjuhën angleze)

60 Magjistër i shkencave ekonomike në fushën e administrimit të biznesit 5000 ** 50

FAKULTETI I TEKNOLOGJISË USHQIMORE DHE TË USHQYERIT	ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	
Teknologji ushqimore	120 Magjistër i teknologjisë ushqimore	750	20
FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE	ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	
Farmacit	120	750	30
FAKULTETI I ADMINISTRIM BIZNESIT-KUMANOVË	ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	30
Administrim biznesi	120 Magjistër i administrimit të biznesit	500	
Administrim biznesi	60 Magjistër i administrimit të biznesit	750	
Administratë publike	120 Magjistër i administrimit publik	500	
FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA	ECTS Thirrja shkencore	Euro Semestër	36
Ndërtimtari	120 Magjistër i ndërtimtarisë	750	
Ndërtimtari konstruktive	<i>moduli</i>		
Infrastrukturë dhe rrugë	<i>moduli</i>		
Arkitekturë	Magjistër i arkitekturës	750	
Projektim	120 <i>moduli</i>		
Projektim	60 <i>moduli</i>		
Mekatronikë	120 Magjistër i mektronikës	750	
Inxhinieri ekonomike	120 Magjistër i inxhinierisë ekonomike	750	

1191

* Programe në proces të akreditimit. Regjistrimi do të bëhet nëse finalizohet procesi i akreditimit.

** Lartësia e pagesës është caktuar në bazë të Vendimit për lartësinë e pagesës për studimet në Administrim biznesi - Program studimor për marrjen e diplomës së përbashkët në ciklin e dytë të studimeve universitare me Northern Illinois University (program studimor në gjuhën angleze) me nr. 02-5583/1 dhe sipas marrëveshjes përkatëse.

** 60 ECTS-Studime njëvjeçare, 120 ECTS-studime dyvjeçare

Në programet studimore ku mësimi do të zhvillohet në gjuhën angleze, kandidatët do të intervistohen për njohuritë në gjuhën angleze nga komisioni përkatës.



II. Kushtet dhe kriteret për konkurrim

a) Të drejtë për konkurrim kanë kandidatët që i plotësojnë këto kushte të përgjithshme:

- Studimet e ciklit të dytë janë vazhdimësi e studimeve themelore.
- Në programet studimore të ciklit II mund të regjistrohet personi i cili ka mbaruar programe studimore përkatëse të ciklit të parë dhe i cili i plotëson të gjitha kushtet të cilat parashihen me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit dhe me Rregulloren e studimeve të ciklit të dytë.
- Në ciklin e dytë të studimeve universitare të specializimit profesional me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestra, respektivisht 60 kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 vjetësh, respektivisht 180 kredi.
- Në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare me kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve ose katër semestrave, respektivisht 120 kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 3 (tre) vjetëve, respektivisht 180 kredi.
- Në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare me kohëzgjatje prej 1 (një) viti ose dy semestrave, respektivisht 60 kredi, mund të regjistrohen kandidatët të cilët kanë të kryer ciklin e parë të studimeve përkatëse në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh, respektivisht 240 kredi.
- Në ciklin e dytë të studimeve akademike universitare mund të regjistrohen edhe kandidatët të cilët kanë të kryer ndonjë program tjetër të ngjashëm pasi t'i kenë dhënë provimet diferenciale të programit studimor në të cilin dëshirojnë të regjistrohen, me suksesin që është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.
- Universiteti dhe njësitë e tij përcaktojnë se cilat studime janë të përshtatshme për regjistrim në programe të veçanta studimore të ciklit II, si dhe kushtet për regjistrimin e kandidatëve të cilët kanë kryer programe të tjera studimore nga programi në të cilin aplikohet.
- Regjistrimi në program të ndryshëm nga programi në të cilin studenti ka diplomuar, mund të bëhet me kusht që kandidati t'i ketë dëgjuar dhe t'i ketë dhënë provimet nga lëndët obligative para komisionit prej 3 (tre) anëtarësh. Kryetari i komisionit duhet të jetë nga lëmi i ngushtë profesional. Përcjellja e ligjëratave nga këta kandidatë bëhet gjatë vitit akademik, ndërsa provimeve duhet t'u nënshtrohen në afatin e qershorit.
- Përshtatshmëria e ciklit të parë të studimeve universitare për regjistrim në ciklin e dytë të studimeve universitare, si dhe kushtet plotësuese për regjistrim në studimet e ciklit të dytë, përcaktohen me aktin e njësisë akademike i cili i organizon studimet me propozim të programit studimor.

b) Shtetas të huaj

Shtetasit e huaj kanë të drejtë regjistrimi në studimet e ciklit II në mënyrë të njëjtë si edhe shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

c) Procedura e seleksionimit

- Të drejtën e regjistrimit, në vitin e parë në studimet e ciklit të dytë, kandidati e fiton në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Konkurs sipas pikëve të fituara në procesin e seleksionimit.
- Në kushte të barabarta, përparësi gjatë regjistrimit kanë kandidatët me notë më të lartë mesatare mbi 7,5 nga suksesi i arritur gjatë studimeve, si dhe kohëzgjatje e përvojës së punës për kandidatët e paraqitur për studime me korrespondencë.
- Komisioni për Konkurs i njësisë, në tabelat e shpalljeve të fakultetit e shpall rangimin, nga rezultatet e arritura në ciklin e parë të studimeve universitare si dhe rezultatet nga kontrollimi i njohurive nga programet studimore në të cilat ai zbatohet.
- Pas shpalljes së ranglistës preliminare të kandidatëve për regjistrim nga Komisioni për Konkurs i njësisë, kandidati ka të drejtë për kundërshtim në afat prej 24-orësh përmes Arkivit ose formës online. Ankesën kandidati ia parashtron Komisionit të njësisë i cili e shpall listën preliminare. Në të kundërtën, e humb të drejtën për kundërshtim në procedurën e mëtejme të ankesave për rezultatet e shpallura.
- Komisioni ka për obligim të sjellë vendim në afat prej 24 orëve, nga momenti i skadimit të afatit për parashtrim të ankesave.
- Në rast se kandidati nuk është i kënaqur me vendimin e sjellë nga ana e Komisionit të njësisë së Universitetit, në afat prej 24 orësh nga dita e shpalljes së vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtë të parashtrorjë ankesë deri te Komisioni qendror. Vendimi i Komisionit qendror universitar është përfundimtar.
- Pas skadimit të afatit për parashtrimin e kundërshtimeve dhe shqyrtimit të tyre, Komisioni qendror universitar në fakultetin përkatës shpall Aktvendim për pranimit e studentëve (Ranglista përfundimtare), në bazë të së cilës bëhet regjistrimi i studentëve. Kandidatët e pranuar si dhe ata të cilët nuk janë pranuar, pas shpalljes së Aktvendimit të komisionit qendror për pranim, nuk kanë të drejtë kundërshtimi ose ankesë.



- Kandidatët të cilët në afatin kohor të paraparë për regjistrim nuk e bëjnë regjistrimin, respektivisht nuk dorëzojnë dokumentacionin e duhur për regjistrim (Dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim) ose fare nuk paraqiten në shërbimet studentore në fakultetin në të cilin janë pranuar, do të konsiderohen se kanë hequr dorë nga regjistrimi.

- Fakultetet të cilat edhe pas përfundimit të afatit të parë të regjistrimit mbeten vende të paplotësuara, bëjnë regjistrim të studentëve në afatin e dytë regjistruar.

d) Studime të rregullta dhe me korrespondencë

- Studenti në studimet e ciklit II mund të regjistrohet si student i rregullt dhe me korrespondencë.
- Programi i studimeve të rregullta u dedikohet studentëve që kanë mundësi t'i ndjekin rregullisht mësimet.
- Njësitë akademike mund të organizojnë studime me korrespondencë nëse e lejon programi studimor dhe lënda studimore.

Studentët me korrespondencë janë ata studentët të cilët programin studimor e ndjekin pjesërisht (përveç punës apo aktiviteteve tjera të cilat kanë nevojë për program specifik).

- Rregullat e studimit si dhe detyrimet e studentit me korrespondencë janë të njëjta me ato të studentëve të rregullt (regjistrimi dhe vërtetimi i semestrit, vijimi në ligjërata, ushtrime, punë laboratorike, përgatitja e punimeve seminarike, puna praktike etj).

- Njësitë e Universitetit e përcaktojnë (me akreditim) formën e organizimit të aktiviteteve mësimore dhe vëllimin e ngarkesës në mësim për studentët me korrespondencë dhe studentët të cilët janë të kyçur në programin mësimor në distancë.

- Programi i studimeve me korrespondencë është i dedikuar për personat e punësuar, për shkak të detyrave të punës, ose për personat, të cilët për shkaqe të ndryshme nuk kanë mundësi t'i ndjekin mësimet e rregullta. Për shkak të karakterit të studimeve, kohëzgjatja e programit të studimeve me korrespondencë është më e gjatë se e studimeve të rregullta, por nuk duhet të jetë më e gjatë se dy vite akademike.

- Kohëzgjatjen e programit të studimeve me korrespondencë e përcakton bartësi i programit studimor të fakultetit përkatës, në varësi të mundësive të studentëve me korrespondencë për ndjekjen e mësimi

III. Shpenzimet për studimet e rregullta dhe me korrespondencë në studimet e ciklit II i mban vetë studenti me vetëfinancim të studimeve, sipas shumës së përcaktuar me pikën I të këtij Konkursi, si taksë shkollimi. Për punimin e temës së magjistraturës, studentët paguajnë 500 euro, mjete të tjera plotësuese. Mjetet për punimin e magjistraturës, respektivisht specializimit, i paguajnë para mbrojtjes së punimit të magjistraturës, respektivisht të specializimit dhe detyrime tjera financiare të përcaktuara me Vendim dhe Rregulloren e ciklit të dytë.

Këshilli i Rektoratit do të sjellë vendim për numrin minimal të nevojshëm të studentëve për fillimin e procesit mësimor në programin studimor përkatës.

IV. Afatet për paraqitje dhe regjistrim

REALIZIMI I KONKURSIT PËR REGJISTRIM TË STUDENTËVE -2019/20	Afati I	Afati II
Aplikimi - dorëzimi i dokumenteve në administratë	09 shtator - 11 tetor 2019	28 tetor-01 nëntor 2019
Shpallja e rezultateve preliminare	14 tetor 2019	4 nëntor 2019
Shpallja e vendimit për pranim të kandidatëve	16 tetor 2019	6 nëntor 2019
Regjistrimi i kandidatëve	16 - 25 tetor 2019	6 - 13 nëntor 2019

V. Dokumentet e nevojshme për aplikim dhe regjistrim

Paraqitja bëhet në Universitetin e Tetovës, Rruga e Ilindenit p.n. 1200 Tetovë, pasi kandidati ta ketë plotësuar formularin online përmes ueb faqes www.unite.edu.mk (Regjistrimet 2019/20).

Kandidati është i obliguar të parashtrijë fletëparaqitje për konkurrim në studimet e ciklit II në afatin e përcaktuar të përcaktuar në pikën IV, të këtij Konkursi.

Në fletëparaqitje kandidati duhet ta përcaktojë programin studimor në të cilin konkurren si dhe statusin e studimit: student i rregullt ose me korrespondencë (nëse me konkurs është përcaktuar mundësia e studimit me korrespondencë).

Krahas formularit për aplikim kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Fletëparaqitje për aplikim (merret nga administrata gjatë dorëzimit të dokumenteve);
- Certifikatë nënshtetësie dhe certifikatë lindjeje;
- Diplomë për kryerjen e arsimit sipëror



- Certifikatë për provimet e dhëna (origjinale). Kandidatët me arsim të lartë të mbaruar jashtë vendit, duhet të dorëzojnë ekuivalentim të notave lëshuar nga MASH (Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RMV-së) dhe të finalizojnë nostrifikimin;**
- Dëshmi për akreditimin e programit nga universiteti për shkollimin paraprak (për studentë shtetas të huaj)**
- Biografi të shkurtër (CV);**
- Vërtetim për njohjen e së paku një gjuhe botërore, të dhënë nga institucioni arsimor adekuat.**
- Rekomandime nga profesorë ose punonjës shkencorë (nëse i posedon ato);
- Vërtetim për përvojë në punë dhe për llojin e detyrave të cilat i ka ushtruar gjatë punës, si dhe kërkesë nga organizata e punës - institucioni, për regjistrim të studimeve pasdiplomike;
- Listë të punimeve shkencore ose profesionale dhe kopje nga të njëjtat (nëse kandidatët kanë të tilla);
- Dëshmi për çmime të fituara, mirënjohje dhe të ngjashme, si dhe dokumente të tjera (nëse të tilla janë paraparë me aktet e institucionit përkatës).
- Vërtetim për pagesë të:
- 1050 denarëve** në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të taksave administrative.

Gjatë regjistrimit, kandidatët e pranuar duhet të dorëzojnë:

1. Fletëparaqitje për regjistrim (fletëparaqitjet merren në shërbimin për çështje studentore të fakultetit në të cilin studenti regjistrohet)
2. Tri fotografi (dy fotografi 6 x 9 dhe një – 4 x 5 c. m.)
3. Vërtetim për pagesën e mjeteve:
 - 1200 denarë**, në xhirollogarinë e Universitetit: në emër të dhënies së Index-it.
 - Pagesën e mjeteve për semestrin e parë

Të gjitha pagesat e lartpërmendura për **ciklin e dytë** do të kryhen në xhirollogarinë e Universitetit, në këtë mënyrë:

Në emri i marrësit (**назив на примачот**) - Universiteti i Tetovës,

Në „banka e marrësit“ (**банка на примач**) – Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut,

Në „llogaria“ (**сметка**) – 10000000063095,

Në „shuma“ (**износ**) – shuma e mjeteve financiare që duhet të paguhen,

Në „llogaria e shfrytëzuesit buxhetor- subjekti shfrytëzues“ (**сметка на буџетски корисник – единка корисник**) – 1600160054 788 25;

në „shifra dhe programi i të hyrave“ (**приходна шифра и програма**) – 723012 43, ndërsa në „mënyra“ (начин) – 2;

Në „thirrja në numrin“ (**повиквање на број – задолжување**) shënohet numri i fakultetit në të cilin studion, në këtë mënyrë:

723012 – 01: Fakulteti Ekonomik,

723012 – 02: Fakulteti Juridik,

723012 – 03: Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore,

723012 – 04: Fakulteti i Shkencave të Mjekësisë,

723012 – 05: Fakulteti Filologjik,

723012 – 06: Fakulteti Filozofik,

723012 – 07: Fakulteti Shkencave të Zbatuara,

723012 – 08: Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore dhe të Ushqyerit,

723012 – 09: Fakulteti i Kulturës Fizike,

723012 – 10: Fakulteti i Arteve,

723012 – 11: Fakulteti i Administrimit të Biznesit.

Në rubrikën qëllimi i realizimit të pagesës (**цел на дознака**) – qëllimi i pagesës (provim, semestri, certifikatë etj)

Pagesat prej jashtë:

NATIONAL BANK OF THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA

Emri: Drzaven Univerzitet vo Tetovo

IBAN: MK07 1007 0100 0066 227

SWIFT BIC: NBRM MK 2X

Konkursi do të shpallet në faqen e internetit: <http://www.unite.edu.mk>, Tetovë. korrik 2019